

VENDIM
Nr. 890, datë 21.10.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2020, MIRATUAR PËR
GJYKATËN E LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatës së Lartë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime personeli”, i shtohet fondi prej 12 200 000 (dymbëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe për pagesën e personelit mbështetës të caktuar pranë tij nga Gjykata e Lartë.

2. Gjykatës së Lartë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime operative”, i shtohet fondi prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, për shpërblimin e ekspertëve dhe shpenzimet e tjera operative të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

3. Efekti financiar, prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1 janar 2020.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe